VENDIM
Nr. 45, datë 29.6.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“

me sekretare Blerina (Çinari) Basha, në datën 3.2.2015 Gjykata Kushtetuese mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 67/34 Akti, që i përket:

KËRKUES: Betim Truci

SUBJEKT I INTERESUAR: Komuniteti Mysliman i Shqipërisë

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. 00-2013-1026, datë 10.5.2013 të Gjykatës së Lartë dhe nr. 1446, datë 20.6.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f, 134/g dhe 142/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Besnik Imeraj; kërkuesin që në parashtrimet e tij me shkrim ka kërkuar pranimin e kërkesës; subjektin e interesuar që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesi Betim Truci ka qenë anëtar i Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë (KMSH-së). Me vendimet nr. 12 dhe nr. 13 të datës 15.9.2010 të këtij këshilli, është bërë shkarkimi i kërkuesit dhe tre anëtarëve të tjerë të KMSH-së.

2. Kërkuesi ka pretenduar se të dyja mbledhjet janë zhvilluar pa pasur kuorumin e duhur të parashikuar në statut dhe rregullore, si rrjedhojë vendimet që janë marrë në këto mbledhje kanë qenë të pavlefshme. Për këto arsye, kërkuesi ka paraqitur padi në Gjykatën e Tiranës me objekt: “Shfuqizimin e vendimit të Këshillit të Përgjithshëm të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, datë 18.9.2010 dhe të vendimeve nr. 12 dhe nr. 13, datë 15.9.2010 të Kryesisë së Komunitetit Mysliman të Shqipërisë”.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 480, datë 31.1.2011, ka pranuar padinë, duke konstatuar pavlefshmërinë absolute të vendimeve nr. 12 dhe 13 të datës 15.9.2010 të Kryesisë së Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.

4. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1446, datë 20.6.2011 ka prishur vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë, duke pushuar gjykimin e kësaj çështjeje. (Gjykata e Apelit Tiranë ka arsyetuar se padia e ngritur mbeti pa objekt dhe se ajo duhet të konsiderohet si një padi që nuk mund të ngrihet). Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2013-1026, datë 10.5.2013, ka vendosur mospranimin e

rekursit.

II

5. ***Kërkuesi*** Betim Truci pretendon shqyrtimin e kërkesës së tij të paraqitur në Gjykatën Kushtetuese, duke parashtruar këto shkaqe:

5.1 Nxjerrja jashtë juridiksionit gjyqësor ka shkelur të drejtat kushtetuese.

5.2 Komuniteti Mysliman ka pranuar regjimin juridik të vendosur nga shteti shqiptar, duke u regjistruar sipas rregullave të përgjithshme, dhe nuk ka se si të shmanget nga këto rregulla.

5.3 Komuniteti Mysliman i Shqipërisë (KMSH-ja) është një shoqatë jofitimprurëse, por është e qartë, gjithashtu, se ka statutin e personit juridik dhe është i detyruar të zbatojë legjislacionin në fuqi.

6. ***Subjekti i interesuar***, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, parashtron si më poshtë:

6.1 Neni 10 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë garanton pavarësinë e bashkësive fetare nga shteti.

6.2 KMSH-ja nuk është organizatë jofitimprurëse, dhe gëzon një status të veçantë.

6.3 KMSH-ja është një bashkësi fetare që gëzon personalitet juridik.

6.4 Shteti shqiptar ka ratifikuar ligjin nr. 10056, datë 22.1.2009, "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Mysliman të Shqipërisë për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella".

6.5 Vendimet e KMSH-së nuk mund të ankimohen në gjykatë për shkak të karakterit "*sui generis*" të bashkësive fetare.

6.6 Bashkësitë fetare gëzojnë tradicionalisht një autonomi organizative të garantuar në kuadër të nenit 9 të KEDNJ-së.

III
Vlerësimi i gjykatës

7. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) vlerëson se pretendimet e ngritura nga kërkuesi janë haptazi të pabazuara.

8. Në referim të kritereve ligjore për legjitimimin, Gjykata vëren se kërkuesi legjitimohet *ratione personae* dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa ka të bëjë me ankimin individual për shkeljen e së drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe është paraqitur brenda afatit 2-vjeçar të kërkuar nga ligji.

A. Lidhur me cenimin e së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës (e drejta e aksesit në gjykatë)

9. Gjykata konstaton se kërkuesi, duke pretenduar se Gjykata e Apelit Tiranë ka nxjerrë pa të drejtë çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor, sipas standardeve kushtetuese, ky pretendim lidhet me mohimin e aksesit për t'iu drejtuar Gjykatës.

10. Subjekti i interesuar ka parashtruar se neni 10 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë garanton pavarësinë e bashkësive fetare nga shteti dhe se vendimet e KMSH-së nuk mund të ankimohen në gjykatë për shkak të karakterit "*sui generis*" të bashkësive fetare.

11. Gjykata vë në dukje, se Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 42 të saj, ka garantuar të drejtën e individëve për një proces të rregullt ligjor për mbrojtjen e të drejtave, lirive e interesave të tyre kushtetuese dhe ligjore, ku një aspekt i rëndësishëm i së cilës është edhe e drejta për t'iu drejtuar gjykatës (e drejta e aksesit). E drejta e aksesit nënkupton jo vetëm të drejtën e individit për t'iu drejtuar gjykatës, por edhe detyrimin e shtetit që t'ia garantojë atij këtë mundësi (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 15, datë 17.4.2003; nr. 9, datë 2.4.2003; nr. 17, datë 18.7.2008; nr. 5, datë 6.3.2009*). Në rast se mohohet një e drejtë e tillë, procesi konsiderohet jo i rregullt, sepse aksesi në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës.

12. Gjykata për rastin në shqyrtim e gjen të arsyeshme të analizojë shkurtimisht tablonë ligjore dhe marrëdhënien juridike të shtetit shqiptar me Komunitetin Fetar Mysliman, i cili ushtron aktivitetin e tij në Shqipëri.

13. E mbrojtur nga neni 9, liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë përfaqëson një prej themeleve të një "shoqërie demokratike" sipas kuptimit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ-së). Neni 10 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë garanton pavarësinë e bashkësive fetare nga shteti.

14. Gjykata konstaton se shteti shqiptar në plotësimin e kuadrit ligjor mbi marrëdhëniet e shtetit me fenë, ruajtjen dhe zhvillimin e harmonisë ndërfetare në vend, përveç marrëveshjeve me komunitete të tjera, me Komunitetin Mysliman në Shqipëri ka ratifikuar ligjin nr. 10056, datë 22.1.2009 "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Mysliman të Shqipërisë për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella". Në nenin 11 të kësaj marrëveshjeje, i cili rregullon organizimin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, citohet se "*në marrëdhëniet me organet, institucionet dhe organizatat e tjera laike e fetare, brenda dhe jashtë vendit, besimtarët e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë përfaqësohen nga organet, funksionarët dhe drejtuesit e formuar, të emëruar a zgjedhur në përputhje me statutin. Komuniteti Mysliman i Shqipërisë ka të drejtë të formojë organet e tij, të emërojë funksionarët dhe drejtuesit e tyre në mënyrë të pavarur, si dhe në përputhje me dispozitat e parashikuara në statutin e tij*".

15. Në rastin në shqyrtim, kërkuesi Betim Truci ka qenë anëtar i Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë. Me vendimet nr. 12 dhe nr. 13 të datës 15.9.2010 të këtij këshilli është bërë shkarkimi i kërkuesit dhe tre anëtarëve të tjerë të KMSH-së.

16. Kërkuesi ka pretenduar se të dyja mbledhjet janë zhvilluar pa pasur kuorumin e duhur të parashikuar në statut dhe rregullore, si rrjedhojë vendimet që janë marrë në këto mbledhje kanë qenë të pavlefshme. Për këto arsye, kërkuesi ka paraqitur padi në Gjykatën e Tiranës me objekt*: "Shfuqizimin e vendimit të Këshillit të Përgjithshëm të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, datë 18.9.2010 dhe vendimeve nr. 12 dhe nr. 13, datë 15.9.2010 të Kryesisë së Komunitetit Mysliman të Shqipërisë*". Gjykata e Apelit Tiranë e ka nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Lartë

17. Gjykata vlerëson se sipas nenit 11/4 të ligjit nr. 10056, datë 22.1.2009 "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella", "Funksionarëve, drejtuesve dhe organeve të bashkësisë u garantohet liri e plotë e ushtrimit të veprimtarisë fetare, organizative e administrative, në përputhje me aktet e këtij Komuniteti, për aq sa kjo veprimtari nuk vjen në kundërshtim me dispozitat kushtetuese dhe ligjore.

18. Edhe në jurisprudencën e konsoliduar të GJEDNJ-së, kjo gjykatë ka konstatuar se ka pasur shkelje të nenit 9 të KEDNJ-së. Në çështjen *Hasan dhe Chaush vs Bullgaria kërkuesit, një ish-kryetar Myfti i fesë myslimane bullgare dhe një mësues i fesë islame, ankimuan për vendimin e autoriteteve bullgare për ndërrimin e drejtimit dhe të statutit të komunitetit mysliman. Këshilli i Ministrave refuzoi të regjistrojë udhëheqjen, pavarësisht nga fakti që Gjykata e Lartë Administrative e kishte dhënë dy herë të drejtë zotit Hasan kundër refuzimit të Këshillit të Ministrave për të regjistruar aktet nënligjore dhe lidershipin.* Gjykata konstatoi se kishte pasur ndërhyrje në organizimin e brendshëm të komunitetit mysliman dhe lirisë së fesë".

19. Në vendimin e saj GJEDNJ-ja konsideroi se faktet tregojnë se dështimi i autoriteteve që të mbeten neutrale në ushtrimin e kompetencave të tyre në lidhje me regjistrimin administrativ të komuniteteve fetare, çon në përfundimin se shteti kishte ndërhyrë në lirinë e besimtarëve për të manifestuar fenë e tyre brenda kuptimit të nenit 9. Kjo ndërhyrje, sipas GJEDNJ-së duhet të bazohet në një ligj që ofron mbrojtje të mjaftueshme kundër kufizimit arbitrar të të drejtave themelore. Në rastin në fjalë, GJEDNJ-ja u shpreh se legjislacioni bullgar nuk ka kritere të qarta dhe të parashikueshme për regjistrimin e udhëheqjes së një komuniteti fetar dhe për këtë arsye nuk ishte në përputhje me standardet

e Konventës Evropiane. Në përfundim, GJEDNJ-ja theksoi se ndërhyrja në jetën organizative të fesë myslimane dhe si pasojë në lirinë e ankuesve për të manifestuar besimin e tyre nuk ishte "*e parashikuar me ligj*", arbitrare si dhe e bazuar në dispozita ligjore që nuk kishin plotësuar standardet e kërkuara për qartësi dhe parashikueshmëri (*shih vendimin e GJEDNJ-së, Aplikimi nr. 30985/96), datë 26.10.2000*).

20. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila e ka nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit, pa e zgjidhur atë në themel, dhe vendimi i mospranimit i Gjykatës së Lartë nuk i kanë cenuar kërkuesit të drejtën e aksesit në gjykatë, si aspekt i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës.

21. Në këtë kontekst, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit nuk i nënshtrohen kontrollit kushtetues, për rrjedhojë janë haptazi të pabazuara.

B. Lidhur me pretendimet e tjera

22. Kërkuesi në thelb të disa pretendimeve, vë theksin se Gjykata e Apelit Tiranë dhe Gjykata e Lartë kanë keqinterpretuar dhe keqzbatuar ligjin.

23. Gjykata ka theksuar se procesi i gjykimit kushtetues është i natyrës argumentuese, që nënkupton se u takon palëve të parashtrojnë argumentet faktike dhe ligjore mbi të cilat mbështesin pretendimet e tyre. Është detyrë e palëve të shpjegojnë arsyet të cilat kanë çuar, sipas këndvështrimit të tyre, në shkeljen e Kushtetutës dhe, më konkretisht, të procesit të rregullt ligjor. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk ka arritur të parashtrojë në mënyrë të plotë faktet dhe pretendimet, mbi bazën e të cilave mbështet pretendimin për cenim të nenit 42 të Kushtetutës. Ai nuk ka arritur të sjellë argumente të mjaftueshme për të argumentuar se në ç'mënyrë është cenuar në të drejtën e tij kushtetuese për një proces të rregullt ligjor nga procesi gjyqësor i zhvilluar në gjykatat e zakonshme.

24. Gjykata Kushtetuese vlerëson se pretendimet e paraqitura janë haptazi të pabazuara, për rrjedhojë kërkesa duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja "a" dhe 134/1, shkronja "f", të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Sokol Berberi, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Besnik Imeraj, Fatos Lulo, Gani Dizdari

Anëtarë kundër: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo

MENDIM PAKICE

Jam kundër vendimit të shumicës për arsyet e mëposhtme:

1. Kërkuesi Betim Truci i është drejtuar Gjykatës për shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën të vendimeve nr. 1446, datë 20.6.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr. 00-2013-1026, datë 10.5.2013 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

2. Në thelb kërkuesi ka pretenduar se vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë, duke konsideruar se kërkesëpadia e tij, me objekt shfuqizimin e vendimeve të Këshillit të Përgjithshëm dhe të Kryesisë së Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, nuk mund të ngrihej, si dhe duke vendosur pushimin e gjykimit të çështjes, i ka cenuar atij të drejtën e aksesit në gjykatë. Edhe vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) për mospranimin e rekursit të tij nuk i ka dhënë përgjigje këtij pretendimi.

3. Në jurisprudencën e Gjykatës e drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një

gjykimi të drejtë dhe publik. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Në këtë kuptim, ky standard përfshin të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën, për çështjet civile përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit në një organ gjyqësor duhet të jetë një e drejtë që lidhet me themelin dhe jo një e drejtë e pastër formale. Aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Mohimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 7, datë 27.2.2013, nr. 14, datë 26.3.2012; nr. 4, datë 23.2.2011; nr. 14, datë 3.6.2009; nr. 7, datë 11.3.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

4. Gjithashtu, Gjykata ka vlerësuar se neni 42 i Kushtetutës sanksionon në vetvete jo vetëm të drejtën e individit për t'iu drejtuar gjykatës, por edhe detyrimin e shtetit që t'ia garantojë atij këtë akses. Gjykata ka konsideruar se sipas këtij neni detyrimi për të garantuar të drejtën efektive të aksesit në gjykatë nuk nënkupton thjesht mungesën e një ndërhyrjeje, por mund të kërkojë ndërmarrjen e veprimeve pozitive nga ana e shtetit. Në rast se mohohet një e drejtë e tillë, procesi konsiderohet jo i rregullt, sepse aksesi në gjykatë është para së gjithash një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (*shih vendimet nr. 5, datë 6.3.2009; nr. 17, datë 18.7.2008; nr. 15, datë 17.4.2003 të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Në rastin në shqyrtim, dy gjykata të niveleve të ndryshme, ajo e shkallës së parë dhe ajo e apelit, jo vetëm i kanë dhënë përgjigje diametralisht të kundërta zgjidhjes së konfliktit, por çka është edhe më e rëndësishme, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se mund të shqyrtojë themelin e çështjes duke dhënë zgjidhjen përkatëse, ndërsa gjykata e apelit ka vendosur pushimin gjykimit, pasi sipas saj aktet e komuniteteve fetare, për shkak të marrëveshjeve të lidhura midis shtetit dhe këtyre komuniteteve fetare, nuk rregullohen nga ligji për organizatat jofitimprurëse dhe si të tilla nuk mund të konstatohen absolutisht të pavlefshme nga gjykata.

6. Në këto kushte, kërkuesi ka pretenduar se vendimi i gjykatës së apelit duke nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit i ka mohuar atij të drejtën e aksesit në gjykatë, si në drejtim të së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës ashtu edhe për të marrë përgjigje përfundimtare për pretendimet e ngritura. Për këtë qëllim ai i është drejtuar Gjykatës së Lartë. Këtyre pretendimeve Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë i përgjigjet me një vendim standard formal mospranimi të rekursit, i cili nuk përmban asnjë arsyetim jo vetëm për të kuptuar shkaqet e këtij qëndrimi, por edhe për ta përligjur vendimmarrjen e tij.

7. Gjykata është shprehur tashmë se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, e aq më tepër i Gjykatës së Lartë. Kur në rekurs janë ngritur pretendime të cilat janë të rëndësishme për verifikimin e kushtetutshmërisë së procesit të zhvilluar në gjykatat e zakonshme, Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e subsidiaritetit, që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në ekzaminimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur lidhur me to (*shih vendimet nr. 4, datë 28.2.2006; nr. 41, datë 29.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Në mendimin tim, e drejta për një proces të rregullt ligjor nuk mund të respektohet pa siguruar garancitë konkrete për individin për të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, pra të drejtën për të filluar një proces që të vendosë për mosmarrëveshjet me natyrë civile. Çështja objekt shqyrtimi paraqet pikërisht veçori të kësaj natyre, pasi gjykata e apelit duke vendosur pushimin e gjykimit, i ka cenuar kërkuesit të drejtën e aksesit në gjykatë, si një prej të drejtave themelore të individit në një proces të rregullt ligjor dhe, në këtë drejtim, Gjykata e Lartë duke mos arsyetuar vendimin e saj nuk i ka dhënë përgjigje këtij pretendimi të tij.

9. Duke shkuar më tej, rasti konkret paraqet si karakteristikë edhe ekzistencën e dy vendimeve të

kundërta të gjykatave të faktit në zgjidhjen e konfliktit konkret. Personalisht jam shprehur mbi këtë rrethanë (*shih mendimet paralele të vendimeve nr. 3, datë 19.2.2013; nr. 26, datë 24.6.2013; nr. 37, datë 30.6.2014 të Gjykatës Kushtetutës*), por edhe Gjykata ka mbajtur qëndrim duke theksuar se roli i Gjykatës së Lartë, si gjykatë e ligjit, është i një natyre të pazëvendësueshme. Ajo i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për të pasur një rol aktiv që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar efektivisht edhe në vendimmarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta, veçanërisht në rastet kur dy gjykata u kanë dhënë përgjigje diametralisht të kundërta pretendimeve të kërkuesit. Nga kjo pikëpamje, Gjykata ka vlerësuar se në çështje të tilla (që shqyrtohen rast pas rasti) kërkuesit, duke mos marrë përgjigje për pretendimet e tij me natyrë kushtetuese, për shkak të vendimit të mospranimit të rekursit, i cenohet e drejta e ankimit në kuptimin substancial, e parashikuar në nenin 43 të Kushtetutës (*shih vendimin nr. 3, datë 5.2.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Si përfundim, në këto kushte, vlerësoj se Gjykata e Lartë duhej ta kalonte çështjen për shqyrtim në seancë plenare dhe të shprehej me vendim të arsyetuar për pretendimet e ngritura nga kërkuesi.

Anëtar: Vladimir Kristo